

Deklaratë për Shtyp

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË
VITI 2008


___ Mars 2009

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për vitin 2008 regjistroi një rritje të mjeteve të rezervës valutore me 192 milionë euro. Viti u mbyll me një deficit të llogarisë korente prej 1,291 milionë eurosh duke arritur në rreth -14.9% të PBB-së. Në krahasim me vitin 2007, deficitin regjistroi një rritje prej rreth 460 milionë eurosh, nga 831 milionë euro. Deficiti i tregtisë së mallrave u thellua me 310 milionë euro gjatë vitit 2008 duke arritur nga 2,104 milionë euro në 2,415 milionë euro. Flukset hyrëse të kapitalit regjistruan vlerën 1,556 duke financuar plotësisht deficitin korent.

I. LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente gjatë vitit 2008 arritën në rreth 9 miliardë euro, duke qenë 12% më të larta se një vit më parë. *Llogaria korente* për vitin 2008 regjistroi një deficit prej 1,291 milionë eurosh, krahasuar me 831 milionë euro në vitin e kaluar. Deficiti korent ndaj PBB-së¹ në vitin 2008 ishte 14.9%, duke shënuar një rritje të ndjeshme ndaj nivelit prej 10.4% të vitit 2007. Thellimi i deficitit pasqyron deficitin e lartë në mallra (nga 2,104 milionë euro në 2,415 milionë euro), rënien e suficitit të *transfertave korente* (nga 1,043 milionë euro në 830 milionë euro)


dhe një zhvendosje në kategorinë *shërbime* nga suficit (13 milionë euro) në deficit (15 milionë euro). Ndërkohë, suficiti në *të ardhura* u rrit nga 217 milionë euro në 309 milionë euro. Rreth 63% e shpenzimeve korente kanë shkuar për financimin e *importeve të mallrave*, ndërkohë që hyrjet valutore janë siguruar nga *eksportet e shërbimeve* dhe *të mallrave* (62%) dhe nga *transfertat korente* të njëanshme (26%). Tremujori i katërt ka regjistruar nivelin më të lartë të deficitit korent përgjatë vitit, me -454 milionë euro.



¹ Si PBB nominale për vitin 2007 është marrë vlera e publikuar nga INSTAT: 982,736 milionë lekë. Për vitin 2008, llogaritjet janë bërë me vlerësimin e FMN-së për PBB-në nominale: 1,064,000 milionë lekë.

II. TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i shkëmbimeve tregtare gjatë vitit 2008 shënoi 4,24 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 17%. *Deficiti tregtar* u thellua me rreth 300 milionë euro duke arritur në 2,4 miliardë euro. Treguesi relativ i deficitit tregtar ndaj PBB-së, për vitin 2008 vlerësohet në rreth 27.9% nga 26.3% në vitin 2007. Shitblerja e mallrave përfaqësoi rreth 46% të veprimeve korente. *Eksportet* shënuan një rritje vjetore prej 17% duke arritur në 916 milionë euro, ndërkohë që për *importet* u paguan 3.3 miliardë euro ose 16% më tepër se një vit më parë. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet mbeti e pandryshuar në nivelin 27%. Eksportet kanë shënuar ritme vjetore të larta rritjeje veçanërisht në tremujorin e dytë dhe atë të tretë (mbi 20%), ndërkohë që rritja vjetore e importeve ka rënë gradualisht nga 18% në tremujorin e parë në 11% në tremujorin e katërt. Tremujori i katërt ka regjistruar deficitin më të lartë përgjatë vitit (-717 milionë euro), kryesisht për shkak të tkurrjes së eksporteve, të cilat shënuan një rënie tremujore prej 14%.



Pagesat për importe janë rritur për pothuajse të gjithë grupmallrat, por në mënyrë të veçantë për grupet *makineri dhe pajisje* (24%), *mallra të përpunuar* (12%) dhe *lëndë djegëse* (26%). Vlera e importeve të këtyre tre kategorive shënoi rreth 60% të vlerës së përgjithshme të importeve. Në krahun e eksporteve, eksportet nga industria e *tekstileve dhe e këpucëve* pësuan një rënie të lehtë, por vazhdojnë të renditen të parat duke siguruar 43% të të ardhurave të përgjithshme nga eksportet. Ndërkohë, zhvillime pozitive ka regjistruar eksporti nga prodhimi i brendshëm i *produkteve minerale dhe metaleve*.



III. ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE

Llogaria e shërbimeve gjatë këtij viti ka regjistruar rritje si në kahun e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Shkëmbimet tregtare në shërbime ishin rreth 3.1 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 9%. Ndaj vitit 2007, shpenzimet janë rritur më shpejt se të ardhurat. Rezultati neto i transaksioneve ishte deficitit prej 15 milionë eurosh përkundëjt suficitit prej 13 milionë eurosh në vitin 2007.

Shërbimet e udhëtimit zënë peshën më të madhe në të ardhurat dhe shpenzimet e shërbimeve, me përkatësisht 78 dhe 68%. Bilanci neto i shërbimeve të udhëtimit shënoi një suficit prej rreth 140 milionë eurosh. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 1,19 miliardë euro ose 20% më tepër se sa në vitin 2007. Rritja e të ardhurave gjatë vitit 2008 ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së numrit të vizitorëve të huaj dhe të emigrantëve. Ndërkohë, rezidentët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit rreth 1,050 milionë euro ose 14% më shumë se një vit më parë. Në këtë rritje ka ndikuar shtimi me 20% i numrit të udhëtarëve dhe një rritje e lehtë e shpenzimeve mesatare ditore.


Llogaria e të ardhurave u mbyll me një bilanc pozitiv prej 309 milionë eurosh, rreth 40% më e lartë se ajo e vitit 2007. Dy burimet kryesore të të ardhurave kanë qenë puna e punëtorëve sezonalë dhe kufitarë, dhe të ardhurat nga investimet në formën e investimeve të portofolit. Shqipëria gjatë vitit 2008 ka paguar 28 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm.

Transferrat korente neto u vlerësuan në rreth 830 milionë euro, nga të cilat rreth 800 milionë euro kanë hyrë në formën e dërgesave të emigrantëve. Këto të fundit shënuan një rënie vjetore prej rreth 16% nga vlera prej 950 milionë eurosh e një viti më parë, duke zbritur nga 12%, në 9.2% të PBB-së.



IV. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Viti 2008 është karakterizuar nga lëvizje të mëdha në *llogarinë financiare*, të cilat rezultuan në një prurje neto prej 1,556 milionë eurosh. Nga këto, rreth 78 milionë euro kanë hyrë në vend në formën e granteve për investime kapitale, ndërsa 1,478 milionë euro në formën e flukseve financiare neto. Flukset hyrëse të kapitalit kanë financuar plotësisht deficitin korent prej 1,291 milionë eurosh, duke siguruar një rritje të mjeteve të rezervave valutore me 192 milionë euro. Llogaria financiare regjistroi rritje të konsiderueshme të detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës dhe rënie të mjeteve të rezidentëve jashtë. Në llogarinë financiare, lëvizjet më të mëdha janë regjistruar në zërat e *investimeve të huaja direkte, huamarrjes shtetërore dhe mjeteve të rezidentëve jashtë*. Hyrjet në formën e investimeve të huaja direkte në ekonominë shqiptare (682 milionë euro) ishin një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare të vendit. Këtë vit këto investime kanë hyrë kryesisht si investime në sektorin financiar dhe si kapital nga privatizimi.



Lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, gjatë këtij viti vlerësohen në 456 milionë euro, nga të cilat 74% kanë shkuar për sektorin publik. Ndërkohë, *huamarrja private* është rritur ndjeshëm ndaj një viti më parë, në 119 milionë euro nga 10 milionë euro.

Rritja e këtyre detyrimeve ka çuar në rritjen e detyrimeve për pagesat e ardhshme të borxhit të jashtëm. *Shërbimi i borxhit të jashtëm* për vitin 2008 ka ulur detyrimet e rezidentëve me rreth 62 milionë euro.

Ndërkohë, mjetet valutore të investuara jashtë ekonomisë shqiptare kanë regjistruar një rënie neto prej 94 milionë eurosh. Kjo rënie vihet re kryesisht në investimet në formën e *depozitave* të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente (225 milionë euro). Gjatë vitit 2008 është vënë re një ndryshim i raportit të mjeteve të investimit. Sistemi bankar këtë vit ka preferuar zhvendosjen e mjeteve nga *depozita* në *investime portofoli*. Mjetet financiare, në formën e *investimeve të portofolit* kanë shënuar një rritje vjetore prej 69 milionë eurosh.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të *rezervave valutore* të autoritetit monetar. *Mjetet e rezervës* u rritën me 192 milionë euro. *Stoku i rezervës valutore* në fund të vitit 2008 shënoi nivelin 1,695 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 4.2 muajve importe të mallrave dhe shërbimeve.

Bilanci i pagesave (në milionë euro).

| | VITI 2007 | T1'08 | T2'08 | T3'08 | T4'08 | VITI 2008 |
|---|-----------|---------|---------|---------|---------|-----------|
| Llogaria korente | (831.0) | (252.1) | (361.2) | (223.1) | (454.3) | (1,290.6) |
| | | | - | | | |
| Eksporti i mallrave | 786.3 | 205.2 | 260.3 | 242.0 | 208.3 | 915.9 |
| Importi i mallrave | (2,890.4) | (739.3) | (842.3) | (824.4) | (925.3) | (3,331.4) |
| Bilanci tregtar | (2,104.0) | (534.1) | (582.0) | (582.4) | (717.0) | (2,415.5) |
| Shërbimet: Kredi | 1,415.2 | 296.6 | 340.9 | 519.2 | 367.3 | 1,524.0 |
| Shërbimet: Debi | (1,402.3) | (332.8) | (391.0) | (457.0) | (357.8) | (1,538.6) |
| Të Ardhurat: Kredi | 278.6 | 112.2 | 106.7 | 130.6 | 118.9 | 468.4 |
| Të Ardhurat: Debi | (61.3) | (49.5) | (56.5) | (29.9) | (23.1) | (159.0) |
| Transferta private pa shpërblim | 982.8 | 249.6 | 216.5 | 186.6 | 150.1 | 802.9 |
| Transferta shtetërore pa shpërblim | 60.1 | 6.0 | 4.2 | 9.8 | 7.3 | 27.2 |
| Llogaria kapitale | 90.1 | 12.9 | 17.7 | 27.2 | 20.3 | 78.2 |
| Llogaria financiare | 758.3 | 180.6 | 341.2 | 163.7 | 792.0 | 1,477.6 |
| Investime direkte | 470.1 | 107.7 | 98.5 | 140.2 | 272.8 | 619.2 |
| Investime portofoli | 18.5 | 1.0 | 0.6 | (11.7) | (59.1) | (69.2) |
| Kapitale të tjera* | 264.2 | 74.8 | 241.8 | 35.9 | 580.1 | 932.7 |
| Gabime dhe harresa neto | 131.2 | 31.6 | 12.1 | 150.6 | (267.5) | (73.2) |
| Bilanci i përgjithshëm | 148.6 | (27.0) | 9.9 | 118.5 | 90.5 | 191.9 |
| Mjetet e rezervës | (148.6) | 27.0 | (9.9) | (118.5) | (90.5) | (191.9) |
| Përdorim huash e kredish nga FMN | 5.5 | (2.9) | 0.3 | (0.7) | (1.8) | (5.2) |
| Ndryshimi total në rezerva | 99.0 | (66.2) | 6.8 | 180.8 | 97.1 | 218.4 |
| nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit | (49.5) | (39.3) | (3.0) | 62.3 | 6.6 | 26.5 |

* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënime:

Rishikimi i të dhënave

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në përputhje me politikat e rishikimit të informacionit statistikor të Bankës së Shqipërisë, statistikave të bilancit të pagesave i janë nënshtruar rishikimit për periudhën janar-shtator të vitit 2008.

Informacion ndihmës për statistikave të bilancit të pagesave

Të dhëna të plota dhe të përditësuara të bilancit të pagesave publikohen çdo tremujor në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, në drejtorinë "Statistika"/Seri Kohore/Statistika të Sektorit të Jashtëm /Bilanci i Pagesave.

Një material i detajuar mbi metodologjinë e përdorur për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave gjendet në drejtorinë "Statistika", seksioni "Publikime për Statistikat", nën titullin *Metodika e Bilancit të Pagesave*.